

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues, me gjyqtarët profesionistë Sahit Krasniqi dhe Hysnije Gashi, anëtar, si dhe me asistimin e sekretares juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PPI nr. 147/13 të datës 31.10.2013, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli, të akuzuarit A.S. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. T.G., pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datë 23 dhe 30 dhjetor 2013, mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 08 janar 2014 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.S., nga i ati S. dhe e ëma E. e vajzërisë A., data e lindjes, në Viti, me vendbanim në Ferizaj rr.”...” pn, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion ekonomist, bashkëpronar i Kompanisë “...”, i martuar babë i dy fëmijëve.

Ë S H T Ë F A J T O R

me datën 27.08.2013, rreth orës 17:00, në rrugën ”Gëzim Sahiti” në Ferizaj, me dashje ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin A.A.1 dhe atë për shkak të problemit të shtëpisë të cilën shtëpi i pandehuri e kishte blerë nga një person nga Vitia, e të cilën shtëpi më herët banka ... ia kishte konfiskuar të dëmtuarit dhe ditën kritike i dëmtuari shkon për rreth shtëpisë me automjetin e tij “Kombi ...”, me ngjyrë të kaltër me targa ... dhe posa afrohet afër oborrit të shtëpisë, po sa vëren i pandehuri merr pistoletën tulla tokarev modeli TT-33 e kalibrit 7.62x25 mm me nr. Serik ЖБ-573, e prodhimit rus, duke shtënë në afërsi prej 2-3 metrash, ka shtënë një herë në pjesën e majtë të veturës dhe pasi që i dëmtuari e ndal veturën, del nga vetura duke e lënë të hapur derën e veturës i akuzuari shtënë edhe një herë në drejtim të të dëmtuarit në një lartësi nga toka prej 1.30 m., por predha nuk e qëllon të

dëmtuarin pasi që dera ishte e hapur por e godet parafangon e automobilit nga ana e brendshme e pastaj i akuzuari edhe një herë shtënë në drejtim të të dëmtuarit dhe e qëllon në këmbën e majtë në regjionin e kofshës i cili nga kjo e shtënë merr lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje multifragmentare e kofshës së majtë e të cilat dëmtime nuk e kanë rrezikuar jetën e tij.

- me të cilën kreu veprën penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së.

nga data e pacaktuar deri më dt. 27.08.2013, në kohë dhe vend si në dispozitivin e parë të kësaj akuze i pandehuri ka mbajtur në mënyrë të paautorizuar armën pistoletën tulla tokarev e modelit TT-33 e kalibrit 7.62x25mm me nr. serik ЖБ-573, e prodhimit rus e të cilin e ka përdorur në rrethana dhe mënyrën si në dispozitivin e parë të kësaj akuze,

- me të cilën kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 178 lidhur me nenin 28, 374 par. 1 si dhe neneve 4, 7, 17, 21, 28, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 par. 1 nënpar.1.2, 80 dhe 83 të KPK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, i

CAKTON

Për veprën penale në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 /tre/vjet.

Për veprën penale në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/muaj.

Ashtu që në bazë të nenit 80 par.1 dhe 2 nënpar.2.2 të KPK-së i

SHQIPTON

DËNIM UNIK BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3 /TRI/ VJET E 3 /TRE/MUAJ, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 29 gusht 2013 deri më datën 30 dhjetor 2013.

Konform nenit 374 par. 3 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme pistoleta e tipit “ Tula Tokarev” e modelit “TT-33”, e kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik ЖБ-573.

Në bazë të nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së Gjykata me aktvendim të veçantë ka ndërprerë masën e paraburgimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 /njëqind/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, kurse shpenzimet tjera procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate.

I dëmtuari A.A.1, për realizimin e kërkesës pasurore–juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzën PPI. nr. 147/13 të datës 31.10.2013, kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Departamenti për Krime të Rënda, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12 nëntor 2013, kurse i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së, kurse u deklarua fajtor për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, kurse avokati i të akuzuarit me datë 25.11.2013, paraqiti kërkesë për hudhjen e akuzës e cila u refuzua përmes aktvendimit të datës 29.11.2013, ashtu që Gjykata caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 23 dhe 30 dhjetor 2013, në të cilin Prokurori i Shtetit Florije Shamolli, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën, siç është paraqitur në versionin e tanishëm të këtij aktgjykimi.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit , për shkak të veprës penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi për këto vepra penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë së të akuzuarit përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së.

Meqë i akuzuari, në shqyrtimin fillestar dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 të KPPK-ës:

- i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij av. T.G.;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedurës hetimore dhe atë përmes mbrojtjes së të akuzuarit, raportit të balistikës, fotografive të vendit të ngjarjes dhe fotografive të gjetjes së armës.
- aktakuza sa i përket kësaj pike nuk përmban shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në shqyrtimin fillestar si dhe në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 178 të KPK-së, përkatësisht nuk e ka kontestuar faktin se me datë 27.08.2013, deri sa ka qenë duke punuar në oborrin e shtëpisë së tij me të dalë në rrugë aty ka kaluar tani i dëmtuari me automjetin e tij kombi e që pasi i njëjti ka dalë nga vetura me shpejtësi të madhe kurse dorën e mbante mbrapa shpinës e i cili ka lëvizë në drejtim të tij deri sa i ka bërëtitur “ largohu - largohu” dhe pasi i dëmtuari vazhdonte në drejtim të tij atëherë ka nxjerrë nga brezi revolen dhe pas repetimit të saj së pari

ka shtënë në drejtim të tokës e pastaj ka shkrepur në drejtim të këmbëve të të dëmtuarit kurse pasi që i njëjti nuk po ndalej duke shkuar në drejtim të tij ka shkrepur edhe plumbin e tretë e që ka goditur të dëmtuarin i cili është rrëzuar në tokë dhe më pastaj i është ofruar dhe janë sharë me të për të kërkuar nga fqinjët dhe punëtorët që ta dërgojnë në emergjencë për ti ndihmuar të dëmtuarit. I akuzuari në mbrojtjen e tij ka shtuar se nga frika është larguar nga aty për të vazhduar në fshatin e tij dhe në polici është dorëzuar pas dy ditëve dhe njëkohësisht duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur.

Një pjesë të rrëfimit të tij i akuzuari e ka përshkruar rrethanat që i paraprinë ngjarjes kritike duke përshkruar deri në detaje gjenezën e problemit pas blerjes së shtëpisë e cila shtëpi ishte e babait të të dëmtuarit por e cila ishte konfiskuar nga ana e ... bankës përmes procedurave përbarimore si dhe problemet që kishin fillin pikërisht pasi që i akuzuari filloi renovimet e shtëpisë, më tutje në mbrojtjen e tij ka vazhduar se kishte ndërmarrë veprime për të tejkaluar këtë situatë përmes ofrimit të shtëpisë kundruall kthimit të vlerës së parave të blerjes pastaj presionet që vazhdimisht kishte nga familjarët e të dëmtuarit (babai dhe vëllezërit e tij) duke potencuar edhe faktin se edhe kishin arritur që t'ia ndalojnë punën në renovim të shtëpisë.

4. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 178 të KPK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;
- nga dëshmia e dëshmitarit – të dëmtuarit A.A.1;
- nga dëshmia e dëshmitarëve F.B. dhe V.B.;

- nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 27.08.2013;
- nga leximi i mendimit të ekspertit mjeko-ligjor të datës 16.10.2013
- mendimi i ekspertit të balistikës prof..H.K. dhënë në shqyrtimin gjyqësor me dt. 23.12.2013;
- nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit i dt. 25.09.2013;
- nga leximi i konkluzionit për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërive të debitorit M.A., akuza e paraqitur ndaj M.A. dhe A.A.2, aktvendimi i caktimit të masës për tu ofruar shtëpisë së të akuzuarit si dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarve M.A. dhe A.A.2.

5.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

- se ditën kritike 27 gusht 2013 rreth orës 17:00, në Ferizaj, rrugën “Gëzim Sahiti” është shtënë tri herë me pistoletën e tipit “ Tula Tokarev” e modelit “TT-33”, e kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik ЖБ-573;
- se me predhën e parë është goditur ana e majtë të automjetit Kombi me targa të regjistrimit ... të cilën e drejtonte i dëmtuari A.A.1;
- pasi i dëmtuari del nga automjeti me një predhë është shtënë në drejtim të tij, në lartësi nga toka prej 1.30m., e cila nga ana e brendshme e godet anën e majtë të parafangos ;
- me predhën e tretë një herë është qëlluar i dëmtuari A.A.1, në pjesën e kofshës së majtë;
- se nga plaga e shkaktuar i dëmtuari ka marrë lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje multifragmentare e kofshës së majtë i cili lëndim nuk ka rrezikuar jetën e të dëmtuarit;
- dhe përfundimisht që tri të shtënat janë bërë nga i akuzuari A.S..

Por, Gjykata ka pasur për detyrë që në këtë çështje penale të ndriçoj dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: versionin e Prokurorit të Shtetit (se vrasja në tentativë është kryer me dashje direkte) dhe versioni i të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij (se tentim vrasja është kryer gjatë mbrojtjes së nevojshme), andaj Gjykata e ndodhur mes këtyre dy versioneve arsyetimin e këtij aktgjykimi do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit- të dëmtuarit A.A.1,¹ është vërtetuar se me datë 27.08.2013, deri sa ka qenë duke shkuar te shoku i tij Sh.H. gjatë drejtimit të automjetit të tij kombi së pari ka dëgjuar një krismë dhe kur ka dalë nga vetura e tij ka parë tani të akuzuarin me revole në dorë distanca mes tyre ka qenë diku 2-2.5 metra dhe pasi që i ka hapur duart dhe ka përdorë fjalët “çka ke more burrë mos gjuaj”, i akuzuari ka shtënë edhe një herë në drejtim të tij por që plumbi i ka shkuar afër duke ushtuar në veshët e tij e cila pastaj ka goditur xhamin e përparmë të kombit e më pastaj është goditur me një plumb në kofshën e majtë, më pas i akuzuari i është ofruar i ka thënë diçka dhe është larguar nga aty deri sa e kanë ndihmuar fqinjët e tij duke e dërguar në Qendrën Emergjente në Ferizaj.

Kurse gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar dënimin e të akuzuarit si dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike pa arritur të përcaktoj shumën e kompensimit.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari dhe posaçërisht ka pasur parasysh faktorët si në vijim:

- së pari se dëshmitari ishte edhe i dëmtuar në këtë çështje penale;
- se raportet mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit dhe familjarëve të tyre nuk ishin të mira që nga koha e blerjes së shtëpisë së babait të të dëmtuarit nga ana e të akuzuarit edhe pse blerja ishte bërë nga një person i tretë (M.H.) dhe atë pas konfiskimit të saj nga ana e ... bankës dhe si pasojë e këtyre raporteve kishte ardhur deri te ngjarja kritike;
- se dëshmitari po e ndiente faktin se babai dhe vëllai i tij ishin të akuzuar me një akuzë që ndërlidhet edhe me këtë ngjarje;

¹ Shih në tërësi deklarinimin e dëshmitari të përshkruar hollësisht në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Andaj të gjitha këto rrethana e bëjnë tejet të vështirë dhe komplekse vlerësimin e kësaj dëshmie, por megjithatë dëshmia e tij ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë që i referohet ngjarjes kritike e që dëshmia e tij në këtë pjesë ishte tërësisht e besueshme, e saktë dhe objektive për më tepër kjo dëshmi nuk përmban në vete zbrastësi apo mangësi logjike dhe e cila plotësohet dhe mbështetet edhe nga provat tjera materiale dhe atë nga ekspertiza mjekoligjore, mendimi i ekspertit të balistikës dhe fotografitë e vendit të ngjarjes.

Kurse sa i përket pjesës tjetër e cila i referohet pjesës para ngjarjes kritike e që gjithsesi edhe kjo pjesë është e rëndësishme nga fakti se këto dy pjesë janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe assesi nuk mund të trajtohen në mënyrë fragmentare dhe të shkëputura nga njëra tjetra, por dëshmitari haptazi në këtë pjesë po fshehte faktet e rëndësishme të cilat padyshim se i dinte përkatësisht pohimet e tij ishin të pavërteta dhe të pabesueshme se dëshmitari nuk po e njihte paraprakisht të akuzuarin si dhe faktin se nuk ishte në dijeni lidhur me mosmarrëveshjet që kishin familjarët e tij dhe i akuzuari, por i njëjti vazhdimisht eskivonte përgjigjet e tij që është plotësisht e kuptueshme për shkak të solidarizimit të skajshëm me familjarët e tij.

Kurse nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarëve F.B. dhe V.B., është vërtetuar fakti se të njëjtit kishin bërë një përpjekje për tejkalimin e problemeve mes të akuzuarit dhe familjarëve të ë dëmtuarit dhe se gjatë kësaj bisede atyre u ishte ofruar edhe një banesë si një lloj i kompensimit por se nuk ishte pranuar nga babai i të dëmtuarit por se i njëjti kishte kërkuar shumën prej 200.000 €.

Edhe pse dëshmitë e këtyre dëshmitarëve nuk ndërlidhen me ngjarjen që ka ndodhë megjithatë dëshmitë e tyre paraqesin rëndësi për shkak të marrëdhënieve paraprake që kanë sjellë deri te ngjarja e ndodhur, andaj Gjykata duke vlerësuar dëshmitë e këtyre dëshmitarëve pati parasysh lidhjet afariste dhe shoqërore të tyre dhe të akuzuarit (me të parin bashkëpronar të fabrikës së ujit "...") dhe me të dytin raporte kontraktuale për kryerjen e punëve të renovimit) dhe se dëshmitë e tyre pothuajse janë identike, të cilët përshkruajnë raportet mes të akuzuarit dhe familjarëve të të dëmtuarit për tentimin e ndërmjetësimit për të tejkaluar mosmarrëveshjet dhe se bazuar në këta faktorë Gjykata dëshmitë e tyre i çmoi të besueshme vetëm në atë masë sa të njëjtat mbështeten dhe plotësohen me prova tjera materiale por gjithsesi provat tjera (konkluzionit për përcaktimit të vlerës së paluajtshmërive të debitorit M.A. edhe të shtëpisë me vlerë prej 221.250 €, akuza e paraqitur ndaj M.A. dhe A.A.2 për veprën penale të kanosjes ndaj të akuzuarit, aktvendimi i caktimit të masës për tu mos ofruar

shtëpisë së të akuzuarit si dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarve M.A. dhe A.A.2) e që këto prova materiale e konfirmojnë se familjarët e të dëmtuarit gjendeshin në një situatë të vështirë të ndodhur në situatë të frustrimit të madh pas konfiskimit të shtëpisë së tyre dhe në këtë situatë po mundoheshin me çdo kusht të parandalonin të akuzuarin në hyrjen në shtëpi siç i drejtohet vëllai i të dëmtuarit (A.A.2) përmes telefonit të akuzuarit “...ti atë shtëpi nuk mundesh me marrë asnjëherë se përndryshe do të vras”² dhe me fillimin edhe të renovimit të shtëpisë dhe oborrit tanimë po bindeshin se në realitet kishin humbur shtëpinë e tyre, e nga kjo arsye edhe këmbëngulësia e tyre që me çdo kusht të pengonin punët rreth renovimit të shtëpisë dhe oborrit e shprehur përmes ndalimit të punëve nga ana e vëllait të të dëmtuarit duke u thënë punëtorëve “...se kush ju ka thënë me punuar këtu se kjo është shtëpia ime...”³ e që kulminacioni kishte arritur kur babai i të dëmtuarit (M.A.) i është kanosur drejtpërdrejt të akuzuarit “ valla bilah këtë shtëpi nuk mundesh me marrë kurrë”⁴.

Nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 27.08.2013, shihen vetëm dy predha (njëra nuk u gjend edhe pse nuk është kontestuese se ishin shkrepur tri predha) si dhe vërehet gjaku i derdhur, pastaj shihet kombi i qëlluar me një plumb në pjesën e poshtme të anës së majtë si dhe parafango e shpuar si pasojë e goditjes me plumbin tjetër, e po ashtu shihen edhe fotografitë e pistoletës dhe karikatorit me një plumb të fshehur nga i akuzuari pas ngjarjes në fshatin Komuna e Vitisë.

Nga leximi i mendimit të ekspertizës mjeko ligjore të datës 16.10.2013, janë përshkruar plagët e pësura nga i dëmtuari A.A.1⁵ dhe duke përfunduar raportin se lëndimet janë kualifikuara si dëmtime të rënda trupore- thyerje multifragmentare e kofshës së majtë i cili lëndim në momentin e shkaktimit nuk ka rrezikuar jetën e të dëmtuarit.

Gjykata mendimit të përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. A.G., i ka falur besim të plotë me që e njëjta është përpiluar në të arritura shkencore, në mënyrë profesionale, për më tepër janë përshkruar në mënyrë të detajuar plagët e pësura nga i dëmtuari, e nuk është gjetur ndonjë rrethanë objektive apo subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtij raporti.

² Shih dispozitivin e akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj ndaj të akuzuarve A.A.2 dhe M.A..

³ Po aty

⁴ Shih dispozitivin e akuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj ndaj të akuzuarve A.A.2 dhe M.A.

⁵ Shih mendimin e ekspertit mjeko-ligjor.

Nga leximi në raportin e ekspertizës i dt.25.09.2013, në lidhje me gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes dhe atë gëzhoja numën D#1 dhe D#3, është vërtetuar se janë shkrepur nga një armë pistoletë e tipit “ Tula Tokarev” e modelit “TT-33”, e kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik ЖВ-573 e evidentuar si dëshmi me nr.D#10 (i cili fakt edhe nuk ka qenë kontestues, pos faktit se një predhë nuk është gjetur në vendin e ngjarjes).

Po ashtu sa i përket dëgjimit të ekspertit të balistikës i cili u dëgjua në shqyrtimin gjyqësor të dt.23.12.2013, paraqiti të dhëna të predhës që qëlloi parafangon i njëjti me argumente shkencore vërtetoi se kjo predhë në mënyrë direkte kishte goditur parafangon nga ana e brendshme e cila ekspertizë nga Gjykata u çmua si profesionale dhe nuk pati ndonjë arsye që të mos i besohet.

Sa u përket provave materiale që ndërlidhen me ngjarjet që i paraprinë objektit të këtij shqyrtimi gjyqësor dhe atë nga leximi i konkluzionit për përcaktimit të vlerës së paluajtshmërive të debitorit M.A. mes tyre edhe e shtëpisë që më vonë ishte blerë nga i akuzuari, akuza e paraqitur ndaj M.A. dhe A.A.2, aktvendimi i caktimit të masës për tu mos ofruar shtëpisë së të akuzuarit si dhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ndaj të akuzuarve M.A. dhe A.A.2, këto prova janë të besueshme meqë janë që të gjitha dokumente publike e për më tepër nuk kontestohet vërtetësia e tyre kurse pësha e tyre provuese sa i përket kësaj çështje i referohen ngjarjeve paraprake që i kanë paraprirë ngjarjes kritike.

6.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në paraqitjen se veprimi i tij ka qenë brenda “mbrojtjes së nevojshme” dhe se vetëm i shtyrë nga frika e sulmit të drejtpërdrejtë nga i dëmtuari për shkak edhe të ngjarjeve që i paraprinë rastit ka qenë i detyruar të veproj duke shkrepur tre plumba dhe që të tre në pjesën e asfaltit për ta mënjeluar sulmin.

Mbrojtja e të akuzuarit është pjesërisht e qëndrueshme dhe është tërësisht e kuptueshme se i njëjti padyshim kishte frikë për shkak të ngjarjeve që po i përjetonte e që për këtë arsye edhe ishte përgatitur siç shprehet “... *revolen e kam bartur vetëm 3-4 muajt e fundit pas kërcënimeve që kam pasur..*”⁶, por Gjykata nuk e besoi rrëfimin e të akuzuarit përkitazi me gjuajtjet e tij, vërtetë nuk ishte kontestuese se gjuajtja e parë dhe e tretë ishin gjuajtje në

⁶ Faqja 12 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dates 30.12.2013

pjesën e poshtme, por se kjo nuk mund të thuhet për gjuajtjen e dytë e cila ishte shkrepur pasi që i dëmtuari kishte dalë nga makina e tij dhe ishin ballë për ballë njëri me tjetrin në distancë prej 2-3 metra, e që gjuajtja e tij në lartësi nga toka prej 1.30 metra (e përcaktuar përmes fotografive të kombit dhe depërtimit të predhës në parafango) dhe që padyshim se këto rrethana objektive determinojnë aspektin subjektiv që tregon se i akuzuari shkrepjen e bëri në pjesën më vitale të trupit të të dëmtuarit siç shprehet edhe vet i dëmtuari “...ka shtënë edhe një herë në drejtimin tim...” për të vazhduar se “...kam pasur një oshtimë në të dy veshët...”⁷ që tregon afërsinë e predhës me të dëmtuarin por vetëm nga rrethanat tjera që nuk vareshin më nga i akuzuari predha nuk e qëllloi atë por që shkoi afër tij dhe goditi anën e brendshme të parafangos. Në fakt po ti analizojmë rrethanat që nuk u qëllua i dëmtuari edhe pse distanca jo fort e largët mes tyre ato padyshim janë te frika dhe mllefë që janë të natyrës psikike momentale dhe mos përgatitja e tij për një rast të tillë e që përveç këtyre faktorëve a nuk e tha edhe vet i akuzuari faktorin determinant se “...unë nuk kam përvojë në gjuajtje meqë edhe për herë të parë kam gjuajtur ditën kritike...”⁸.

Aspekti tjetër i mbrojtjes së të akuzuarit lidhur me të shtënë e tretë, se e shtëna ka qenë në pjesën e poshtme të tokës e që predha pasi që ka goditë në asfalt ka goditur parafangon, e kjo demantohet në tërësi përmes ekspertit të balistikës prof. H.K. i cili në shqyrtimin gjyqësor me argumentim profesional dhe shkencor pohoi faktin se e shtëna në parafango ishte gjuajtje direkte dhe atë nga ana e brendshme dhe e eliminoj tërësisht mundësinë e rikoshetimit të predhës nga fakti se predha e rikoshetuar lëvizë në kënd të njëjtë me gjuajtjen dhe se me këndin e gjuajtjes (siç rezulton nga shkresat dhe fotografitë që i kishte në dispozicion) predha nuk do ta kishte qellur xhamin.

Kurse aspekti i fundit që Gjykata e sheh të nevojshme ta analizoj në mbrojtjen e të akuzuarit është pretendimi i tij se veprimi ishte drejtuar me qëllim të mbrojtjes së nevojshme dhe se kjo analizë duhet mbështetur dhe bazuar në kontest të tërësisë së ngjarjes dhe se ska aspak dyshim se i akuzuari kishte frikë, por ditën kritike ishte tepër e qartë se i dëmtuari kur doli nga automjeti i tij nuk kishte asgjë në dorë dhe se edhe vet i akuzuari në këtë pikë është konfuz dhe dezorientues edhe në mbrojtjen e tij deri sa gjatë procedurës hetimore dy ditë pas ngjarjes pohon se “... ai e ka hapur derën e kombit dhe ka dashtë të marr diçka mbrapa karriges së shoferit...”⁹, kurse në shqyrtimin gjyqësor potencon faktin se i dëmtuari “...ka

⁷ Faqja 7 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dates 30.12.2013

⁸ Faqja 13 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dates 30.12.2013

⁹ Procesverbali i dëgjimit të të akuzuarit i datës 29.08.2013.

*dalë nga vetura me shpejtësi të madhe dorën e ka pasur mbrapa... ”¹⁰, andaj është tepër sinjifikative se pse i akuzuari nuk e potencoi këtë fakt “*dorën mbrapa*” gjatë hetimeve por i “*kujtoi*” në shqyrtimin gjyqësor dhe ska si të vlerësohet ndryshe veç faktit se kjo ishte një konstruktiv i mbrojtjes së tij me qëllim të shmangies përkatësisht zvogëlimit të përgjegjësisë penale.*

7.Vlerësimi i tezës së mbrojtësit të akuzuarit

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, av. T.G., të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar lirim nga akuza duke pretenduar se vepra penale ka ndodhur gjatë mbrojtjes së nevojshme, e duke vazhduar më tutje se edhe vetë të shtënat me armë kanë qenë në tokë dhe se edhe vet goditja e të dëmtuarit është në pjesën e poshtme, që sipas pretendimeve të tij, për më tepër ai shton faktin se edhe plumbi i mbetur në karikator të pistoletës dhe mundësia që i akuzuari edhe me automjet ta godiste të dëmtuarin tregojnë se i akuzuari nuk ka pasur motiv për ta vrarë të dëmtuarin për veprimi i tij ishte kryer si pasojë e frikës që i akuzuari kishte si dhe faktin se edhe i dëmtuari dhe familjarët e tij (babai dhe vëllai) kanë kontribuar në ngjarjen e ndodhur sidomos është ndalur veçanërisht në trajtimin e marrëdhënieve paraprake mes të akuzuarit dhe familjarëve të të dëmtuarit.

Por, Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

Së pari është e domosdoshme të analizohet instituti i *mbrojtjes së nevojshme* si rrethanë e përjashtimit të përgjegjësisë penale, i cili përkufizohet në nenin 12 të KPK-së:

“Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.”

Por gjithsesi është e nevojshme që për tu konsideruar se është vepruar gjatë mbrojtjes së nevojshme, duhet vërtetohen disa rrethana konkrete që ndodhën pikërisht në momentin e zhvillimit të ngjarjes:

- *së pari a pati në të vërtetë sulm nga ana e të dëmtuarit A.A.1*, Gjykata vlerëson se përgjigjja është e qartë dhe e prerë se nuk ekzistonte sulm nga ana e të dëmtuarit e këtë nuk e

¹⁰ Faqja 11 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dates 30.12.2013

pohon as edhe vet i akuzuari i cili nuk është konsistent në paraqitjen e fakteve, të kujtojmë se gjatë hetimeve pohon se i dëmtuari po merrte “*diçka pas karriges së shoferit*” për të ndryshuar esencialisht këtë gjatë shqyrtimit gjyqësor se “*dorën e mbante mbrapa*”, por Gjykata vlerëson se në fakt nuk kishte ndodhur as njëra e as tjetra, meqë do të ishte në tërësi e palogjikshme dhe e panatyrshme që të tentohej të sulmohej apo të sulmohej i akuzuari që po mbante në dorë një pistoletë;

- *cila ishte shkalla e rrezikut që kanoste të akuzuarin nga ana e të dëmtuarit, po ashtu shkalla e rrezikut ndaj të akuzuarit ishte e papërfillshme dhe e vogël për më tepër disproporcionale meqë i akuzuarit si duket ishte përgatitur duke bartur me vete vazhdimisht në 3-4 muajt e fundit një pistoletë me vete padyshim siç edhe vet pohon nga fakti i marrëdhënieve të acaruar që kishte me familjarët e të dëmtuarit, por veprimi i ndërmarë do të mund të shmangej përmes veprimeve më të lehta gjuajtje paralajmëruese në ajër;*

- *a pati në të vërtetë tejkalim të mbrojtjes së nevojshme, i cili pretendim është ngritur po ashtu nga mbrojtja, gjithsesi se përgjigjja është dhënë më lartë por megjithatë për tejkalim të mbrojtjes së nevojshme është e nevojshme që tronditja e fortë apo frika nga sulmi duhet të jetë e atëçastshme dhe se në fakt edhe nga provat e elaboruara ishte e qartë se i akuzuari ishte i frikësuar nga ndonjë sulm i mundshëm por i dëmtuari ishte pikërisht personi që më së paku ishte i kyqur në këto raporte dhe se vet prania e tij në afërsi të shtëpisë së të akuzuarit nuk do të ishte ndonjë shenjë e sigurt për ndonjë sulm të mundshëm;*

- *sa i përket mundësisë që i akuzuari të vazhdonte me gjuajtje tjera pasi që kishte edhe një plumb në pistoletë dhe mundësia që të shkaktonte lëndim apo vdekje të dëmtuarit me automjet, padyshim se kjo mundësi ekzistonte dhe se kjo mund të arrihej pa asnjë pengesë por kjo nuk duhet lidhur me veprimet paraprake të të akuzuarit por këto rrethana se ai e ndaloi sulmin dhe nuk e vazhdoi, gjithsesi janë të rëndësishme por assesi determinonte dhe që të paraqesin bazë për lirim të të akuzuarit por mund që ti kreditohen si rrethana lehtësuese me rastin e matjes së dënimit;*

- *dhe së fundi raportet mes të akuzuarit dhe familjarëve të të dëmtuarve, padyshim se këto raporte ishin skajshmërisht jo të mira dhe gjithsesi i akuzuari që nga blerja e shtëpisë po kalonte një periudhë mjaft të vështirë dhe se po mundohej që të gjente zgjidhje dhe po ofronte kompromise të pamërituara familjarëve të të dëmtuarit të cilët nuk po pajtoheshin se kishin humbur shtëpinë e tyre nga hipoteka e vendosur dhe se shkaktar të kësaj humbje ishin*

ata vet dhe jo ndonjë fajtorë kujdestar që e gjetën pikërisht tek i akuzuari por megjithatë edhe këto rrethana mund të jenë rrethana që janë çmuar me rastin e matjes së dënimit, meqë edhe sjellja konkrete e të akuzuarit nuk mund të amnistohet dhe të tolerohet meqë edhe autoritetet shtetërore po ndërmerrnin veprime lidhur me rastin e paraqitur nga i akuzuari.

8. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale vrasja në tentativë nga neni 178 të KPK-së, e cila përcaktohet edhe nga përshkrimi ligjor i dispozitës së nenit 178 të KPK-së është përcaktuar: “*Kushdo që e privon nga personin tjetër nga jeta*”, kurse edhe nga përshkrimi ligjor i dispozitës së nenit 28 të KPK-së është përcaktuar:

“ Kushdo që me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale ”

Nga kjo rrjedhimisht është e pakontestueshme që i akuzuari, ka shtënë tri herë nga të cilat dy herë në pjesën e poshtme nga të cilat herën e parë është shtënë në automjetin kombi të cilin e drejtonte i dëmtuar, herën tjetër në drejtim të të dëmtuarit në afërsi dhe në lartësi prej 1.30 m nga toka që në fakt gjuajtja ishte në pjesën më vitale të trupit edhe pse i dëmtuari nuk u qëllua, kurse me të shtënë e tretë është qëlluar i dëmtuari në pjesën e kofshës së majtë duke i shkaktuar lëndim të rëndë trupor, e që janë realizuar në tërësi tiparet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale dhe atë:

elementi *actus reus (elementi i jashtëm)*, i vërtetuar përmes faktit se kemi të bëjmë me tentim të privim nga jeta të personit tjetër duke i ndërlidhur me ekzistimin e :

-lidhjes kauzale mes veprimit të akuzuarit dhe pasojës së mundshme i realizuar përmes shkrepjes tri herë me pistoletë;

- e që njëra predhë ishte e drejtuar drejtpërdrejt në të dëmtuarin në lartësi nga toka prej 1.30 m. që nënkupton në pjesët më vitale të trupit por që nuk arrin ta godet të dëmtuarin por e godet pjesën e brendshme të parafangos;

- dhe njëra predhë e godet të dëmtuarin në kofshën e majtë duke i shkaktuar lëndim të rëndë trupor pa rrezikuar jetën e tij.

Kurse elementi i lartcekur ndërlidhet edhe me elementin mens rea (qëllimi i brendshëm mendor kriminal), i vërtetuar përmes veprimeve konkrete të të akuzuarit:

- se i akuzuari ishte i vetëdijshëm se përmes veprimit të tij të manifestuar përmes shkrepjes në pjesën vitale të trupit (edhe pse nuk e qëlloi predha) por po të qëllohej i dëmtuari do të mund shkactohej vdekja;

- i shprehur edhe përmes aspektit volutiv, se vet shkrepja e predhës në drejtim të të dëmtuarit, për më tepër i vazhdimet edhe më tutje duke shtënë edhe me predhën e tretë po në drejtim të të dëmtuarit tregon dashjen direkte për kryerjen e kësaj vepre penale dhe se mos shkaktimi i pasojës përkundër ndërmarrjes së veprimeve të shkrepjes më nuk varej nga vullneti i tij.

10. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari është i moshës relativisht të re, deri më tani i padënuar me aktgjykim të formës së prerë, e këto rrethana i ndërlidhi me rrethanat veçanërisht lehtësuese se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shprehur keqardhje dhe pendim të sinqertë dhe real për veprimin e kryer, rrethanat e kryerjes së veprës penale përkatësisht rrethanat që sollën të akuzuarit para këtij akti sidomos gjendjen e tij për disa muaj nën presion të vazhdueshëm nga familjarët e të dëmtuarit dhe përpjekjeve të tij të maksimale dhe të vazhdueshme për tejkalimin e kësaj situate, e posaçërisht duhet potencuar faktin se me këtë rast ka aplikuar edhe dispozitën përkatëse të përcaktuar te tentativa se ndaj kryerësit mund të zbutet dënimi kurse ka bërë pranimin e fajësisë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPK-së, por me rastin e vlerësimi të rrethanave rënduese ka gjetur rrethana minore në mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e tij pas kryerjes duke ikur nga vendi i ngjarjes dhe duke iu shmangur për dy ditë paraqitjes para organeve të rendit.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit,

rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), se përmes këtij dënimi do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, kurse posaçërisht në rastin konkret është e rëndësishme të potencohet se përmes këtij dënimi të arrihet të evitohet eskalimi i mëtutjeshëm i zingjirit të dhunës që potencialisht mund të zgjerohet mes të akuzuarit të dëmtuarit dhe familjarëve të tyre.

11.Konfiskimi, llogaritja e paraburgimit, kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Gjykata konform nenit 374 par. 3 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme pistoletën e tipit “ Tula Tokarev” e modelit “TT-33”, e kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik ЖВ-573, meqë me dispozitë përkatëse është përcaktuar konfiskimi i obliguar.

Në dënimin e shqiptuar është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit duke aplikuar nenin 83 par. 1 të KPK-ës, kurse në kuptim të nenit të nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë ka ndërprerë masën e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin A.A.1, që realizimin e kërkesës pasurore – juridike mund ta realizon në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruara gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishtme për të vendosur lidhur me këtë kërkesë.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, Gjykata obligoi të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 /njëqind/€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË
RËNDA, me PKR.nr.237/2013**

Sekretarja juridike,

Albana Ajvazi

Kryetari i trupit gjykues,

Agim MALIQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, kurse i dëmtuari mund të ushtroj ankesë ndaj këtij aktgjykimi vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal.